



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА

ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT

STATE AUDIT OFFICE



ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT

Njoftim për mediumet -

Shkup, 16.03.2023

Të realizuara 52% e aktiviteteve për reformën e administratës publike

Anulimi i miratimit të ligjeve të reja kyçe, prolongimi i procesit të riorganizimit të organeve shtetërore, realizimi jo i plotë i aktiviteteve të planifikuara dhe kapaciteti i pamjaftueshëm i kuadrit


Duke pasur parasysh se sipas Metodologjisë së re për anëtarësim në BE, **reforma në administratën publike** është fushë që është pjesë e proceseve të negociatave në kuadër të Klasterit -Vlerat Fundamentale, Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e suksesit me temë **“Reforma në administratën publike”**, për t’iu përgjigjur pyetjes:

“A sigurojnë aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente, zbatim efikas të Strategjisë për reforma në administratën publike 2018-2022”


Me revizion janë konstatuar gjendjet si vijojnë:

- **afatet për miratimin e ligjeve kyçe për zbatimin e reformave në administratën publike vazhdimisht anulohen.** Procedura për miratimin e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik, Ligji për nëpunësit administrativ dhe Ligji për shërbimin e lart udhëheqës që ka filluar në vitin 2019 dhe e njëjta vazhdon akoma;
- **emërimi i shpeshtë i ushtruesve të detyrës – u.d. drejtorëve.** Në periudhën prej 2018 deri 2021, 52% nga numri total i personave të emëruar udhëheqës janë u.d. drejtorë ose zëvendës të tyre, zgjedhja e të cilëve është pa shpallur konkurs publik,

që ndikon në profesionalizmin e shërbimit të lartë udhëheqës, menaxhim të mirë në institucionet e sektorit publik dhe e zvogëlon llogaridhënien e procedurës për përzgjedhjen e personave udhëheqës të institucioneve;



- **mungesë e dokumenteve për mënyrën e planifikimit dhe përpilimit të strategjisë**, për faktin se e njëjta nuk është pjesë e arkivit të MSHIA-së, ndërsa personat që kanë menaxhuar me këtë proces nuk janë më të punësuar në MSHIA, me çka nuk sigurohet memoria institucionale për procesin;
- është miratuar plani i veprimit i rishikuar për zbatimin e strategjisë, me të cilin janë kryer **ndryshime në 33% të aktiviteteve të planifikuara**, janë përcaktuar aktivitete të reja, janë kryer ndryshime në afatet e zbatimit dhe të indikatorëve për matjen e suksesit, si dhe është zvogëluar ahuma e mjeteve të planifikuara financiare,
- **për sa i përket kapaciteteve të kuadrit për përmbushjen e qëllimeve reformatore**, janë konstatuar ndryshime të shpeshta, ekipimi i pamjaftueshëm i kuadrit, realizim jo të plotë të kompetencave të trupave përgjegjës për procesin e reformave, si dhe komunikim dhe koordinim joefikas vertikal dhe horizontal i të gjithë pjesëmarrësve në proces;
- Këshilli për reforma në administratën publike është trupi më i lartë politik për koordinim të aktiviteteve. **Në periudhën prej 2018 - 2022 janë kryer gjashtë ndryshime** në përbërjen e tij, si pasoj e ndryshimeve të vazhdueshme strukturore në Qeveri, me vetëm **shtatë takime të mbajtura në periudhën katërvjeçare**, kurse prej korrikut të vitit 2021 deri në fund të 2022, më shumë se një vit e gjysmë, nuk është mbajtur seancë e re;
- **gjithsej mjetet e planifikuara** për zbatimin e masave të Strategjisë janë **1.802.140 mijë denarë, gjegjësisht rreth 30 milion euro**, me pjesëmarrjen më të madhe mbi 56% të siguruara nga fondet dhe instrumentet e BE-së;
- nga 205 aktivitete të planifikuara janë realizuar vetëm **106 aktivitete që paraqet realizim prej 52%**.



- nuk është realizuar transparenca, llogaridhënia dhe monitorimi i mjeteve financiare të shpenzuara në buxhetin e shtetit, sepse përveç MSHIA, institucionet e tjera nuk kanë hapur nënprogram të veçantë në kuadër të programit Qeveritar K – Reforma në administratën publike;
- nuk është kryer vlerësimi i plotë i efikasitetit të procesit të reformës në administratën publike, **nga gjithsej 79 indikator të paraparë, janë matur vetëm 28 indikator për matjen e suksesit të aktiviteteve, respektivisht vetëm 35%;**
- MSHIA nuk ka vendosur evidencë të sistematizuar për secilin aktivitet nga strategjia, si dhe raportet gjysmëvjetore dhe vjetore nuk përmbajnë të dhëna për mjetet e planifikuara dhe të realizuara,
- raporti i katërt vjetor nga viti 2021 nuk përmban pasqyrë të plotë financiar dhe është dhënë analizë vetëm për **mjetet e shpenzuara** në vlerë prej **1.111.359 mijë denarë**, gjegjësisht **për rreth 18 milion euro**, që paraqet 61% nga mjetet totale të planifikuara për periudhën 2018-2022;
- nuk është vendosur sistem i TI-së për monitorim, vlerësim dhe njoftim për aktivitetet reformuese, me çka nuk janë krijuar kushtet për mbledhjen dhe përpunimin sistematik të informacioneve dhe të dhënave për vlerësimin e zbatimit të reformave në administratën publike.

Duke pasur parasysh se një administratë publike funksionale është parakusht për qeverisje demokratike efektive dhe transparente, për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara, deri te trupat dhe institucionet kompetente për koordinim të aktiviteteve, Enti Shtetëror i Revizionit dhe rekomandime që janë në funksion të përmirësimit, forcimit dhe krijimit të sistemit efikas të planifikimit, zbatimit, monitorimit, vlerësimit dhe njoftimit për realizimin e aktiviteteve në Strategjinë e re për reforma në administratën publike 2023-2030, me synim për reforma të suksesshme në administratën publike, si qëllim strategjik i shtetit.

Press kontakti:

Albiona Mustafa Muhaxhiri +389 72 228 203 albiona.mustafa@dzt.gov.mk

Mijałçe Durgutov +389 70 358 486 mijalce.durgutov@dzt.gov.mk

Martin Duvnjak +389 75 268 517 martin.duvnjak@dzt.gov.mk